



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2020:172237

Datë: 12.06.2024

Numri i dokumentit: 05812423

KA.nr.603/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli-Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit PZ Group me seli në Prizren, fshati Sërbicë e Poshtme, kundër të paditurës Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të Vendimit Nr.07/04/2-001543 të datës 09.11.2020, jashtë seancës, me datë 28.05.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. **HEDHET** padia e paditësit PZ Group me seli në Prizren, kundër të paditurës Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të Vendimit Nr.07/04/2-001543 të datës 09.11.2020 , **si e paplotësuar**
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.

A r s y e t i m

Paditësi PZ Group shpk me seli në Prizren me datën 08.12.2020 ka parashtruar padi, kundër të paditurës kundër të paditurës Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të Vendimit .07/04/2-001543 të datës 09.11.2020

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë, vërejti se paditësi nuk e ka paguar taksën gjyqësore për padi, andaj me datë 26.02.2024 i ka dorëzuar paditësit vërejtjen për pagesë të taksës gjyqësore në adresën Rr.Remzi Ademaj nr.34 Prizren, mirëpo, e njëjta është kthyer në gjykatë me datë 06.03.2024 me raport “e panjohur”, e konstatuar e date: 29.02.2024; 01.03.2024 dhe 04.03.2024.

Pas kësaj, Gjykata në shkresat e lëndës gjeti një adresë tjetër ku dorëzoi përsëri vërejtjen për taksë në adresën fshati Sërbicë e Poshtme dhe e njëjta përsëri është kthyer në gjykatë me datë 18.03.2024, me raport “ e panjohur”.

Si rezultat i kësaj, gjykata me datë 19.04.2024 mori aktvendim me të cilin paditësit i'u kthye padia në plotësim, me detyrimin që ta njoftoj gjykatën për adresë të selisë në të cilën ushtron veprimtarinë, dhe të njëjtën e vendosi në Tabelë të shpalljes, ku qëndroj 7 ditë.

Duke vepruar konform Nenit 114 të LPK, ku përcaktohet se *në qoftë se dorëzimi i shkresës subjektivit të regjistruar në regjistrin publik nuk mund t'i bëhet në adresën e treguar në regjistër, komunikimi bëhet duke u ngjitur shkresa në tabelën e shpalljeve të gjykatës, dorëzimi konsiderohet i kryer pas skadimit të afatit prej shtatë ditësh nga dita e afishimit në tabelën e shpalljeve të gjykatës*, gjykata me datë 14.03.2024 publikoi thirrjen për plotësim të padisë me adresë të saktë të paditësit, konform nenit 99 dhe nenit 253 të LPK dhe për pagesë të taksës e cila qëndroj e publikuar 7 ditë, dhe edhe pas kalimit të afatit prej 8 ditëve gjykata nuk ka pranuar të dhënat e kërkuara e qe *e pamundësojnë zhvillimin e procedurës*.

Pas kalimit të afatit gjyqësor, gjykata vërejti se pala paditëse nuk i ka kryer veprimet procedurale si në aktvendimin e datës 19.04.2024.

Andaj, bazuar në Ligjin për Konfliktet Administrative, nenit 33 nenit 33, Nëse padia nuk është e plotë, është e pakuptueshme ose ka të meta, kryetari i kolegjit do të ftojë paditësin, që: *brenda afatit prej tetë (8) ditëve t'i mënjanojë të metat e padisë. Në ftesë duhet të ceken udhëzimet për të mënjeluar të metat e padisë dhe paralajmërimi për pasojat që do të lindin nëse nuk vepron sipas kërkesës së gjykatës, dhe Nëse paditësi, brenda afatit të cekur, nuk i mënjanon të metat e padisë,*

course ato janë të atilla që e pamundësojnë zhvillimin e procedurës, gjykata do ta hedhë poshtë me vendim padinë, nëse nuk konstaton se akti administrativ i kontestuar është i pavlefshëm.

Andaj, gjykata konsideron se mungesa e adresës pamundëson zhvillimin e procedurës dhe vendosi si në pikën I të këtij aktvendimi. Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 64 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm

Ka.nr.603/22, datë 28.05.2024

Gjyqtarja
Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.